



ARSYETE E ZBULIMEVE GJEOGRAFIKE

- ❖ Deri në fund të shek.XV evropianët, përveç Evropës dinin edhe për Lindjen e Afërt dhe të Largët dhe për disa pjesë të Azisë dhe Afrikës.
- ❖ Mbanin lidhje të mira tregtare me vendet aziatike **Indinë** dhe **Kinë**. Prej andej në Evropë sillnin **erëza** dhe **mëlmesa** me të cilat ushqimet i bënin më të shijshme, pastaj mëndafsh, gurë të cmueshëm, parfume, ngjyra etj. Megjithatë, me pushtimin e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël nga osmanet dhe me asgjësimin e Perandorisë Biznatine(1453), u ndërpreu rrugët tregtare tokësore kah vendet lindore. Tani, malli nga vendet lindore që vinte në Evropë nëpërmjet tregtareve arabë u bë shumë i shtrenjtë (8 deri në 10 herë më i shtrenjtë!). Për këtë arsye, evropianët filluan të kërkojnë rrugë të reja detare kah vendet lindore, që solli deri te zbulimi i vendeve të reja.



- Për blerjen e mallrave nga vendet lindore harxhoheshin shumë para, prandaj në Evropë filloi të ndjehet mungesa e metaleve të çmueshme (ar, argjend) prej të cilave priteshin monedhat. Vecanërisht njehej mungesa e monedhave të arta. Në Evropë në atë kohë, nuk ishte e mundur që të shuhet etja e shtuar për ar, prandaj evropianët filluan të kërkojnë ar jasht kufijve të saj.





Periudha e zbulimeve të mëdha gjeografike

- Gjatë shekullit XV horizonti i njohurive gjeografike mbi planetin tonë zgjerohet mjaft. Evropianët njihen hollësisht me të gjitha pjesët e kontinentit të tyre. Me ndërmjetësinë e arabëve dhe me shkëmbimin tregtar ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, janë njohur hollësisht vendet e Afrikës Veriore, Lindjes së Afërt dhe të Mesme. Misionet diplomatike, fetare dhe tregtare të shteteve evropiane, të cilat kanë shkuar në Indi, Mongoli dhe në Kinë, kanë kontribuar në njohjen gjeografike të vendeve të Azisë Jugore, Qendrore dhe Lindore



- Fundi i shekullit XV paraqet fillimin e epokës së re në jetën e popujve të Evropës. Ajo është epoka e paraqitjes së rendit të ri shoqëroro-politik, përkatësisht të kapitalizmit. Në këtë kohë diktatura shpirtërore e kishës shkallmohet. Veprat e filozofëve dhe shkencëtarëve antikë u bënë të afërta njerëzve të arsimuar. Në këtë kohë janë arritur suksese të mëdha në shkencë, teknikë dhe në detari. Teknika e lundrimit u përsos. Anija me vela, me fund të mprehtë (me kil), me kurvertë të lartë dhe të lëvizshme ishte e aftë për t'iu përballur me sukses valëve të larta detare. U përsosën edhe instrumentet e navigacionit (busulla, skafioni dhe kaudranta), të cilat orientoheshin dhe e caktonin pozitën e anijes në horizont. Shpejt zhvillohet tregtia dhe rritet rëndësia ekonomike e politike e qyteteve. Paratë bëhen si mjet i pagesës.



- Evropa nuk ka disponuar sa duhet metale të çmueshme (ar dhe argjend), që janë përdorur si mjete të pagesës. Ngase evropianët më tepër kanë blerë sesa kanë shitur mallra të ndryshme, solli deri te zvogëlimi i rezervave të arit në Evropë. Evropianët nuk kanë mundur të importojnë mallra drejtpërdrejt prej prodhuesve aziatikë, por nëpërmjet të ndërmjetësuesve arabë, persianë dhe grekë. Kjo dukuri shkaktoi rritjen e çmimeve të mallrave që vinin prej Indisë, Arkipelagut të Malajës dhe Kinës. Prandaj, evropianët ishin të detyruar të kërkojnë rrugë detare për në Lindje, me motiv që të lirohen nga ndërmjetësuesit. Përveç kësaj, prania e Turqisë në Lindje të Afërt dhe luftërat e shpeshta, kanë paraqitur pengesën kryesore për mbajtjen e tregtisë me anë të rrugëve tokësore, që kalonin nëpër Lindje të Afërt. Të gjitha këto kontribuan që të intensifikohen hulumtimet për zbulimin e rrugës detare për në Indi dhe vendet e Lindjes së Largme.



- Në këtë kohë nëpërmjet arabëve, evropianët u njoftuan me kuptimet e harruara mbi formën sferike të Tokës, ku në pjesën perëndimore të Oqeanit Atlantik gjenden ujdhesat që i takojnë Azisë. Prandaj, rruga për vendet e arit, argjendit, gurëve të çmueshëm, mendafshit dhe erëza është kërkuar kah perëndimi, përmes Oqeanit Atlantik. Në anën tjetër, anijet më të përsosura të pajisura me busulla, kanë mundur të lundrojnë më lirisht në oqeanet e gjera.





- Që prej kohës së Aristotelit (shekulli IV p.e.s.), Eratostenit (shekulli III deri II p.e.s.) e më vonë të Marin Tiritit (Feniki) dhe Ptolemeut (shekulli I deri II), ka mbisunduar mendimi se largësia ndërmjet buzëdetit të Evropës dhe të Azisë Lindore nuk është e madhe, madje edhe më e shkurtër sa që shpie nëpërmjet Aleksandrisë deri në Indi.
- Ai gabim e ka sjellë Kolombon deri në bregdetin e Amerikës, ose siç ka cekur gjeografi francez i shekullit XVIII Zhan Batista Anvil, ka qenë gabimi më i madh i Kolombos, që e ka sjellë deri në zbulimin më të madh.






KRISTOFOR KOLOMBI

- Kristofor Kolombo, u lind më 1451 në Gjenovë (Itali). Në moshën e re ka punuar në punëtorinë e endjes, pronar i së cilës ishte babai i tij. Si fëmijë ëndërronte mbi lundrimet në dete të largëta. Më 1479 erdhi në Lisbonë dhe u punësua në shërbimin detar portugez. Patí fatin të martohet me të bijën e një detari portugez, me prejardhje italiane, prej të cilit kishin mbetur shumë harta detare dhe shënime të rëndësishme për detari. Për ta mbajtur familjen e vet dhe për ti ndihmuar prindërit në Gjenovë, përpilonte harta gjeografike, të cilat, asokohe, kërkoheshin shumë. Duke ushtruar profesionin e detarit u dallua më aftësi të jashtëzakonshme





- Më 03.08.1492 tri anije me 120 udhëtar të ndihmuar në mënyrë financiare nga mbretëresha spanjolle dhe nga detari i njohur nga Palosi, Martin Pinson, u nisën për lundrim prej limanit Palos. Drejtimi i lundrimit ishte perëndimi, ndërsa caku ishin vendet e pasura të erurinave të Azisë. Kështu filloi lundrimi më i rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Gjatë lundrimit, Kolomboja mbajti edhe ditarin (ditari i parë i shkruar në historinë e detarisë), në të cilën regjistronte çdo ditë rrugën e kaluar, drejtimin e lundrimit e gjëra të tjera që i ka konsideruar të rëndësishme. Kolomboja së pari lundroi në drejtimin jugperëndimor, kah ujdhesat e Kanarive, e pastaj ka marrë drejtimin perëndimor. Anijet e tij, të shtyera nga erërat e përshtatshme të pasateve, me shpejtësi lundruan kah perëndimi.





- Por, më 16 shtator, ekspedita gjendej në "oqeanin e mbuluar me bar", që e ngadalësuan mjaft lëvizjen e anijeve dhe tmerroi ekuipazhin. Ky ishte Deti Sargas që është në përbërjen e Oqeanit Atlantik, i njohur për nga sasia e madhe e algave. Me 12 tetor 1492 Kolomboja zbarkoi në një ujdhesë të vogël ranore, të cilën indigjenët (vendësit) e quanin Guanahana. Ajo i takon grupit të ujdhesave të Bahameve (Bahamas) dhe gjendet në juglindje të Floridës. Duke e shpallur si pronë të Perandorisë Spanjolle, Kolomboja këtë vend e pagëzoi San Salvador, që do të thotë "Shpetimtar i Shenjtë". Duke menduar se ka arritur në Indi, Kolombi banorët e ketij i quajti indianë. Ky emër ka mbetur deri me tani për popullsinë autoktone të Botës së Re. Kolombi edhe pse nuk hasi në sasi të mëdha të arit dhe të argjendit, për herë të parë pa misrin, pataten dhe duhanin. Më 4 janar të vitit 1493 nisët të kthehet në Spanjë i bindur se e ka zbuluar Indinë, Japoninë dhe Kinën. Si dëshmi të zbulimeve të tij, solli në Spanjë sasi të vogla të arit, disa bimë interesante, disa shpezë të egra dhe disa banorë të këtyre ishujve. Më 15 mars të vitit 1493 arriti në Spanjë ku u prit si triumfues i vërtetë. Më qëllim të zgjerimit të zbulimeve të veta, Kolombi organizoi ekspeditën e dytë në shtator të vitit 1493, e cila përbëhej prej 17 anijesh dhe 1500 udhëtar.



- Në këtë ekspeditë morën pjesë edhe disa oborrtarë, fisnikë, priftërinj dhe murgj. Më anë të kësaj ekspedite u zbuluan Antilet e Vogla Porto-Riko dhe Xhamajka. Kolombi dërgoi disa sende të çmueshme në Spanjë, por këto sende kanë pasur një vlerë të vogël, në krahasim me shpenzimet që janë bërë rreth përgaditjes së ekspeditës. Prandaj, mbreti dhe mbretëresha e Spanjës e prishin marrëveshjen me Kolombin dhe Kolombit nuk i mbeti asgjë tjetër, pos të kthehet në Spanjë (1496). Më 1498 Kolombi me mundime të mëdha organizoi ekspeditën e tretë për të gjetur vendin e vërtetë ku kishte ar, argjend, gurë të çmueshëm dhe mëlmesa. Këtë herë ai prej Spanjës lundroi kah jugperëndimi dhe arriti në grykëderdhjen e lumit Orinoko dhe zbuloi Trinidad. Pastaj kthehet në Haiti dhe në Spanjë. Më 1502 Kolomboja organizoi ekspeditën e katërt dhe të fundit. Këtë herë ai zbuloi brigjet prej Hondurasit deri në Panamë dhe disa ishuj pranë Panamasë.



- Më 1506 Kristofor Kolombi vdiq në mjerim të thellë, i harruar plotësisht, me privilegje të humbura, me bindje se e ka zbuluar rrugën detare për në Indi, e duke mos e ditur se kishte zbuluar "Botën e Re" - Amerikën. Me udhëtimet e Kolombos janë zbuluar shumë rruge të Arkipelagut të Bahameve, Antileve të Vogla dhe të Mëdha, Trinidad dhe pjesët e kontinentit të Amerikës së Mesme e Jugore.



AMERIKO VESPUČI

- Amerigo Vespuçi (1451-1512) ka qenë tregtar i pasur nga Firenca, por në shërbim të Spanjës. Besohet se në Amerikë udhëtoi katër herë. Ai supozon se Kolomboja nuk arriti në Indi, por zbuloi Botën e Re (Mundus Novus).



AMERIGO VESPUCCI




- Në veprën e vet me titull "Hyrje në Kozmografi", të botuar më 1507 në gjuhën latine, kozmografi gjerman Martin Valdzemiler propozon që për territorin që tani përfshin Brazilin, të quhet Terra Amerika (Toka e Amerigos).
- Me zgjerimin e mëtejshëm të horizontit të gjeografisë, termi Amerikë zgjerohet për tërë kontinentin, i cili shtrihej prej Alaskës dhe Labradorit në veri, deri në kepin Horn në jug.





VASKO DE GAMA

- Vasko de Gama (1469-1524), atij iu besua organizimi i ekspeditës së parë detare portugeze për zbulimin e rrugës detare rreth Afrikës për në Indi. Ekspeditën që ai e udhëhiqte e përbënin tri anije me 160 detarë. Anijet filluan lundrimin prej Lisbonës, më 8 korrik të vitit 1497. Pasi lundruan pranë Ujdhesave të Gjelbra dhe Kepit të Shpresës së Mirë, vazhduan të lundrojnë në ujërat e Oqeanit Indian.





***KJO ESHTË RRUGA QË AMERIKO VESPUCI
NDOQI PËR TË ZBULUAR TOKENË E RE***



- Në brigjet perëndimore të Indisë, përkatësisht në limanin Kalikut, atëherë qyteti më i madh dhe më i pasur i Indisë, Vasko de Gama me ekspeditën e vet hyri më 20 maj të vitit 1498. Mallin që e sjellë, e këmbëu me gur të çmueshëm, me ar, me pëlhurë të mëndafshtë dhe me erurina. Vasko de Gama, lë Kalikutën dhe kthehet në Lisbonë, më 10 qershor të vitit 1599. Me këtë definitivisht u zbulua rruga detare për në Indi dhe bëhet e mundshme tregtia e drejtpërdrejtë, ndërmjet shteteve evropiane me vendet e Lindjes. Vasko de Gama arriti atë që synuan spanjollët dhe detari i tyre Kristofor Kolombo. Kthimi i Vasko de Gamës, prej Indisë në Portugali, errësoi mjaft famën e Kolombit. Atëherë për herë të parë është dëshmuar se Afrika nuk është e lidhur me Kontinentin Jugor, përkatësisht me Terra Australinë. Mbreti i Portugalisë Vasko de Gamën e emëroi "admiral i detit Indian" me një rrogë vjetore prej 300.000 realash. Vasko de Gama edhe dy herë udhëtoi në Indi



- Deri te hapja e Kanalit të Suezit, më 1869, tregtia kryesore e Evropës me vendet që shtrihen në bregdetin e Oqeanit Indian dhe me Kinën, bëhet nëpërmjet Oqeanit Atlantik, pranë Kepit të Shpresës së Mirë. Më këtë Deti Mesdhe ka humbur rëndësinë e vet të dikurshme. Gjithashtu bie rëndësia e Venedikut dhe Gjenovës, që deri atëherë gati tërë tregtinë me vendet e Lindjës e kanë pasur në duart e tyre. Rolin e tyre e marrin Lisbona me disa qytete të tjera të Portugalisë dhe të Spanjës, të cilat zhvillohen shpejtë, ndërsa Portugalia dhe Spanja në shekullin XVI bëhen shtete të fuqishme detare.




Rruga që ndoqi Vasco De Gama për të zbuluar rrugë të reja.



FERDINANT MAGELANI

- Ferdinand Magelani (1470-1521), pikëpamjet e veta ia paraqiti mbretit të Portugalisë, Manuelit, por ai nuk tregoi kurrfarë interesimi për përgatitjen e ekspeditës së lundrimit rreth e përqark botës. Prandaj, Magelani ka qenë i detyruar të lëshoj Portugalinë dhe të shpërngulet në Spanjë. Të njëjtin plan (mendim) ia paraqiti edhe mbretit të Spanjës. Oborri mbretëror i Spanjës e pranoi planin e Magelanit





- Ai me pesë anije dhe 265 anëtarë të ekuipazhit, më 20 shtator 1519 nisët prej limanit San Lukar (në grykëderdhjen e lumit Guadalkivir) kah perëndimi në drejtim të Amerikës Jugore. Flota e Magelanit më së pari arriti në brigjet të Kanarive, e pastaj u drejtua kah jugperëndimi dhe arriti në buzëdetin e Brazilit. Në muajin janar, ekspedita hyri në gjirin e Rio de Zhaneiros dhe duke menduar se kanë arritur në grykëderdhjen e gjerë të ndonjë lumi, e kanë pagëzuar me emrin e përmendur - Rio de Zhaneiro, që do të thotë "Lumë i janarit".
- Anëtarët e ekuipazhit dimri i zuri pranë bregdetit të Patagonisë, prandaj u detyruan që atje të qëndrojnë prej 31 marsit deri më 18 tetor të vitit 1520. Këtu marinarët e Magelanit u takuan me popullsinë autoktone, të cilët i quajtën patagonë, që do të thotë "këmbëmëdhenj", sepse këmbët i kanë pasur të mbështjella me lëkurë të kafshëve. Ekspedita, pas shumë peripetsish, gjeti kalimin ndërmjet Amerikës Jugore dhe Tokës së Zjarrtë dhe kaloi në Oqeanin e Paqësorit



- ✦ Për nder të këtij detari të shquar, më vonë kjo ngushticë u quajt ngushtica e Magelanit. Anëtarët e ekspeditës e kanë pagëzuar edhe bregun e Tokës së Zjarrtë. Duke lundruar pranë brigjeve së përmendur, në të cilën popullsia autoktone gjatë natës kishte ndezur zjarre të mëdha. Magelani e pagëzoi "Toka e Zjarrtë" (Tierra Del Fuego).
- ✦ Kur doli prej ngushticës, ekspedita vërejti hapësirën madhështore oqeanike, në të cilën lundruan pandërprerë 99 ditë. Gjatë tërë kohës së lundrimit, oqeani ka qenë i qetë, pa valë, prandaj anëtarët e ekspeditës e quajtën Oqeani i Qetë (Paqësor). Pas shumë përpjekjesh, ekspedita arriti deri tek Arkipelagu i Marianeve, pastaj deri të brigjet Filipine, ku Magelani me 27 prill të vitit 1521 ka vdekur në luftë me popullsinë autoktone. Pastaj ekspedita, nën udhëheqjen e Sebastin del Kanos, vazhdoi lundrimin në Oqeanin Indian, nëpërmjet Kepit të Shpresës së Mirë dhe prapë hyri në ujërat e Oqeanit Atlantik. Pas lundrimit të mundimshëm trevjeçar, vetëm me anijen "Viktoria", me 18 anëtar të ekuipazhit të mbetur gjallë, me 6 shtator të vitit 1522 hyri në limanin San Lukar. Me këtë përfundoi lundrimi i parë rreth Tokës, me anë të cilit është dëshmuar se Toka e ka formën sferike dhe qëndron pezull në gjithësi.



- Me këtë lundrim definitivisht bëhet e qartë se detet dhe oqeanet, përfshijnë një sipërfaqe shumë të madhe të Tokës dhe se oqeanet ndërmjet veti janë të lidhura dhe formojnë detin botëror të unisuar.
- Të gjitha këto zbulime nga ana e spanjollëve dhe portugezëve kanë kontribuar në zhvillimin e shpejtuar të tregtisë, detarisë dhe të ekonomisë në përgjithësi, e bashkë me këtë, edhe në lidhjen e marrëdhënieve të reja shoqëro - politike, përkatësisht në lindjen e kapitalizmit.



Udhetimi i Magelanit rreth botes.



Zbulimet gjeografike te shek. XVI - XVIII

- ✿ Zbulimet e mëdha gjeografike nga fundi i shekullit XV dhe në fillim të shekullit XVI kanë pasur rëndësi të madhe për zhvillimin e shkencës në përgjithësi e në veçanti të gjeografisë. U pa se mendimet e dhëna deri atëherë mbi formën dhe madhësinë e Tokës si dhe mbi shpërndarjen e kontinenteve dhe të deteve në të, nuk i përgjigjen realitetit. Me zbulimin e rrugëve dhe vendeve të reja janë krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e tregtisë



- Tregtia e zhvilluar ka kërkuar anije më të përsosura e më të shpejta dhe harta e mjete të tjera bashkëkohore. Për një kohë relativisht të shkurtër, filluan zbulimet e reja teknike dhe zhvillimi i shpejt i hartografisë.

